

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT

LËNDA: Edukim muzikor

(klasa e tetë)

Tiranë, 2006

1. Të përgjithshme

Edukimi muzikor në klasën e tetë të shkollës 9-vjeçare ka si synim aftësimin e mëtejshëm të nxënësve në njohjen, përjetimin e muzikës, shprehjen e emocioneve përmes një terminologjie të thjeshtë muzikore. Në këtë klasë nxënësit do të marrin njohuritë nëpërmjet linjave të këndimit, bazave të arsimimit muzikor, dëgjimit muzikor, luajtjes në instrument, krijim/shprehje, ku të gjitha së bashku dhe veç e veç, do të ndihmojnë nxënësit në formimin muzikor, me njohuri, aftësi, qëndrime dhe vlera.

Njohuritë muzikore për ritmet e përziera 5/8, 7/8, 9/8, historia e muzikës dhe periudhat e zhvillimit të saj, duke përfshirë në to gjinitë kryesore dhe përfaqësues të këtyre periudhave dhe gjinive etj., shkallët me *1 – 2 # dhe 1- 2 b*, muzikën popullore dhe të kultivuar shqiptare etj., do të përshkojnë programin e këtij niveli.

Formimi muzikor përfshin jo vetëm njohuritë, por edhe një sërë veprimtarish muzikore, të cilat aftësojnë nxënësit në bërjen e këtyre veprimtarive. Ato janë të ndërthurura me këngën, dëgjimin e pjesëve muzikore, veprimtaritë ritmike dhe harmonizimin e lëvizjeve ekspresive të trupit, luajtjen me instrumentin e fyellit (në mungesë të tij me tastierën), veprimtari të cilat përfshijnë improvizimin dhe krijimin.

Programi nuk zhvillon vetëm aftësitë praktike, por u jep mundësi nxënësve, zhvillojnë aftësitë e tyre për të arsyetuar, duke menduar dhe duke shprehur në mënyrë kritike emocionet rreth muzikës. Ata i gjejnë të gatshme ose i krijojnë vetë ato. Gjithashtu ky program krijon mundësinë për të përjetuar muzikën dhe shprehur e emocionet përmes arteve të tjera si: vizatimi, poezia, vallëzimi etj.

Ky program zhvillohet në 35 javë mësimore me 2 orë në javë përgjatë gjithë vitit shkollor. Gjithashtu, ai jep mundësinë që në tema të veçanta muzika të integrohet edhe me lëndë të tjera. Nxënësit do të mësojnë të zbulojnë dhe të ndërtojnë lidhjet ndërmjet muzikës dhe edukimit figurativ, letërsisë, historisë, gjeografisë dhe të kuptojnë rëndësinë e muzikës si burim kënaqësie dhe si mënyrë komunikimi brenda një kulture dhe me kulturat e tjera.

2. Synimet

Programi synon të zhvillojë shprehitë për të kënduar, për të dëgjuar, për të luajtur, për të krijuar, si dhe për t'u shprehur duke vlerësuar muzikën.

Mësimi i muzikës synon që nxënësit në fund të klasës së tetë:

- ▶ Të këndojnë saktë dhe me ndjenjë “Himnin e flamurit” ;
- ▶ Të këndojnë kanone, këngë për fëmijë, të huaja, popullore, me një tematikë të larmishme, me vesh dhe me nota;
- ▶ Të zhvillojnë shprehitë e të kënduarit;
- ▶ Të zbatojnë konceptet dhe teorinë muzikore;
- ▶ Të luajnë në instrumentin e fyellit;
- ▶ Të shoqërojnë këndimin me instrumente ritmike dhe ORF;
- ▶ Të njohin dhe të dëgjojnë muzikë të periudhave të ndryshme;
- ▶ Të përjetojnë muzikën duke zhvilluar aftësitë krijuese, lidhur edhe me artet e

tjera.

3. Linjat e përmbajtjes

Ky program është i organizuar në bazë të 5 linjave të mëposhtme:

1. Këndimi,
2. Bazat e arsimimit muzikor,
3. Luajtja në instrument,
4. Dëgjim muzikor,
5. Shprehje dhe krijim muzikor.

4. Objektivat , njohuritë dhe aftësitë kryesore sipas linjave

LINJA I. Këndimi

Në këtë linjë të mësohen 8-9 këngë për fëmijë, të kultivuara, popullore, të huaja me një ose dy zëra, si dhe kanone. Çdo këngë dhe kanon mësohet në 2 orë dhe në disa raste në 3 orë kur është e vështirë.

Objektivat

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- ▶ të këndojnë shumë saktë dhe me ndjenjë “Himnin e Flamurit”;
- ▶ të këndojnë këngë tematike për këtë moshë, popullore polifonike dhe të veriut, të huaja, me një ose dy zëra;
- ▶ të këndojnë duke zbatuar shprehitë vokale gjatë të kënduarit, si:
 - rregullat e frymëmarrjes,
 - qëndrimi drejt,
 - diksioni,
 - këndimi me ndjenjë,
 - frazimi i rrjedhshëm etj.;
- ▶ të këndojnë kanone në grup me dy zëra;
- ▶ të këndojnë solo;
- ▶ të këndojnë në grup (ansambël/kor);
- ▶ të përjetojnë ndjenjën ritmike dhe melodike (5/8, 7/8, 9/8) përmes këndimit të këngëve në këto ritme;
- ▶ të këndojnë dhe të interpretojnë me ndjenjë dhe në mënyrë shprehëse;
- ▶ të shprehin mendimin rreth muzikës që ata këndojnë.

Njohuri dhe aftësi kryesore: që do të fitojnë nxënësit në këtë linjë janë: Ritmi, kohët e thjeshta 2/4, 3/4, 4/4, kohët e përziera 5/8, 7/8, 9/8. Interpretimi me ndjenjë dhe emocion i këngëve, mbajtja e qëndrimit ndaj tyre, përdorimi i shprehive vokale gjatë të kënduarit.

LINJA II. Bazat e arsimimit muzikor

Objektivat

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- ▶ Të njohin, të dallojnë, të shkruajnë, të lexojnë dhe të këndojnë:
 - shkallët me #, b;
 - shkalla Sol + dhe mi – (shkalla me 1 #);
 - shkalla Fa + dhe re - (shkallë me 1 b).;

-shkalla Re + dhe si – (shkalla me 2 #);
-shkalla Sib + dhe re - (shkallë me 2 b);

► të njohin, të dallojnë, të shkruajnë, të lexojnë dhe të këndojnë: ritmet e përziera: 5/8, 7/8, 9/8;

► të lexojnë dhe të këndojnë shembuj të ndryshëm nga folklori ynë me ritmet e përziera.

Njohuri dhe aftësi kryesore: që do të fitojnë nxënësit në këtë linjë janë: Shkalla Sol + dhe mi – , shkalla Fa + dhe re - , shkalla Re + dhe si – , shkalla Sib + dhe re - , ritmet e përziera: 5/8, 7/8, 9/8. Ndërtimi i shkallëve me 2 # dhe 2 b, këndimi i tyre në ngjitje dhe në zbritje.

LINJA III. Luajtja me instrument

Në këtë linjë nxënësit do të mësojnë të lidhin njohuritë muzikore me luajtjen në instrument. Ata duhet të luajnë dhe manipulojnë gjatë luajtjes me instrument ritmet e thjeshta muzikore dhe ato të përziera.

Objektivat

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të luajnë në fyell ushtrime në kohë të thjeshta;
- të luajnë ushtrime në kohët 5/8, 7/8, 9/8;
- të luajnë shembuj të thjeshtë për fyell (popullore);
- të shoqërojnë pjesë të ndryshme popullore edhe me instrumente ORF;
- të zbatojnë tempin dhe shenjat e ngjyimit gjatë luajtjes;

Njohuri dhe aftësi kryesore: që do të fitojnë nxënësit në këtë linjë janë: Luajtja në fyell i ritmeve të përziera 5/8, 7/8, 9/8, luajtja saktë e ushtrimeve muzikore.

LINJA IV. Dëgjimi muzikor

Në këtë linjë nxënësit do të njihen me historinë e muzikës dhe periudhat në të cilat merr zhvillim ajo, gjinitë, përfaqësuesit. Gjithashtu nxënësit mësojnë për muzikën popullore sipas krahinave të ndryshme të vendit tonë, karakteristikat e tyre. Ata njohin karakteristikat e muzikës së kultivuar dhe e dëgjojnë atë. Gjithashtu ata jo vetëm njihen, përcaktojnë dhe dëgjojnë muzikë por mësojnë si të shpjegojnë dhe mbajnë qëndrim ndaj muzikës që ata dëgjojnë.

Objektivat

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- Të njohin zhvillimin e muzikës, *përfaqësuesit dhe veprat e tyre*;
 - në periudhën e lashtësisë: përfaqësuesit kryesorë dhe gjinitë më të zhvilluara;
 - në periudhën e mesjetës dhe të rilindjes (*barok*). Përfaqësuesit kryesorë dhe gjinitë më të zhvilluara;
 - të muzikës popullore: kënga dhe vallja popullore;
 - muzika polifonike dhe homofonike, vlerat e tyre;
 - të muzikës së kultivuar shqiptare: përfaqësuesit dhe veprat e tyre;
- të dëgjojnë duke mbajtur qëndrim ndaj muzikës së këtyre periudhave.
- të përsërisin duke rikultuar periudha, përfaqësues, vepra muzikore etj.

Njohuri dhe aftësi kryesore: që do të fitojnë nxënësit në këtë linjë janë: baleti, opera, kënga popullore, vallja popullore, muzika e kultivuar etj. Njohja, dëgjimi dhe mbajtja qëndrim ndaj pjesës që dëgjon.

LINJA V. Shprehje dhe krijim muzikor

Në këtë linjë nxënësit aftësohen për të krijuar, modeluar, përjetuar dhe improvizuar përmes njohurive muzikore të marra.

Objektivat

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- ▶ të krijojnë në kohët 5/8, 7/8, 9/8;
- ▶ të krijojnë modele të thjeshta ritmike në kohët e mësuara;
- ▶ të përjetojnë muzikën nëpërmjet arteve të tjera: vizatim, poezi etj.;
- ▶ të krijojnë melodi mbi një ritëm të caktuar;
- ▶ të improvizojnë ritme të ndryshme në përshtatje me melodinë;

▶ të listojnë disa veprimtari që zhvillohen në komunitetin e tyre ose në jetën e tyre të përditshme, si: muzika e dëgjuar në televizion, festat familjare, festat apo spektaklet në krahinë apo në vend.

Njohuri dhe aftësi kryesore: që do të fitojnë nxënësit në këtë linjë janë: modelimi, interpretimi, improvizimi, krijimi, përjetimi, modelim mbi ritmet e përziera. Interpretimi i saktë këngëve, improvizimi i saktë i muzikës, krijimi i një melodie mbi një tekst të dhënë, përjetimi përmes arteve të tjera.

5. Shpërndarja e orëve

Në klasën e tetë të arsimit të detyruar 9-vjeçar, edukimi muzikor zhvillohet në 35 javë mësimore me 2 orë në javë. Përdorusit e këtij programi duhet të kenë parasysh që të planifikojnë orë përsëritjeje të vazhdueshme mbi njohurive të marra.

$$35 \text{ javë} \times 2 \text{ orë} = 70 \text{ orë vjetore}$$

Linjat	Sasia e orëve
Këndimi	22 orë
Bazat e arsimimit muzikor	12 orë
Dëgjim muzikor	12 orë
Luajtje në instrument	8 orë
Shprehje dhe krijim muzikor	6 orë
Orë të lira	10 orë

Orë të lira

Qëllimi i orëve të lira (deri në 15% e sasisë totale të orëve) janë lënë të lira në dispozicion të mësuesit. Statusi i tyre është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël. Është i detyrueshëm sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor. Është fleksibël sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është lënë në dorë të

mësuesit në bashkëpunim me drejtoritë arsimore, drejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës.

Qëllimi i orëve të lira është t'i lërë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me objektivat e programit zyrtar të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Për mbushjen e tyre me material mësimor mund të përdoren burime të ndryshme, por gjithmonë të bëhet kujdes të punohet për arritjen e kërkesave të programit.

Grumbullimi i fakteve, të dhënave të ndryshme kulturore, historike, gjeografike, demografike, mund të kthehen në një burim të vlefshëm për të organizuar orë mësimore interesante.

Organizimi i ekskursioneve me karakter kulturor dhe artistik brenda dhe jashtë shkollës, të shoqëruara me veprimtari praktike; organizimi i vizitave në qendra të ndryshme kulturore, janë në shërbim të një objektivi të caktuar të programit; organizimi i konkurseve brenda klasës; organizimi i një koncerti, biseda me artistë të ndryshëm, përforcimi i njohurive i shoqëruar me metoda e strategji që fuqizojnë si të nxënët ashtu edhe mësimdhënien, janë disa veprimtari rekomanduese për rubrikën e orëve të lira.

Për mbushjen efikase të një pjese të orëve të lira mund të bashkëpunohet edhe me mësuesit e lëndëve të tjera duke hartuar paraprakisht një plan të përbashkët disa orësh që shfrytëzon lidhjet konceptuale ndërlëndore dhe aspektet kroskurrikulare. Nxënësve u jepet një detyrë e cila përfshin njohuri ndërlëndore dhe u shërbën arritjes së objektivave të programeve të disa lëndëve dhe objektivave kroskurrikulare.

Shpërndarja dhe varieteti i veprimtarive, duke ju gjetur vendin e duhur përgjatë vitit mësimor, është një element i rëndësishëm i zbatimit me sukses të rubrikës të orëve të lira.

Kujdes duhet bërë që orët e lira të mos shpërdorohen duke i shfrytëzuar për qëllime rutinë të cilat nuk sjellin risi të reja në kurrikulin shkollor.

6. Integrimi

Ky program jep mundësinë që në tema të veçanta muzika të integrohet edhe me lëndë të tjera. Gjithashtu njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat që nxënësit marrin në këtë lëndë përdoren edhe në lëndë të tjera

Integrimi në linjën e këndimit mund të bëhet me: gjuhën amtare (duke interpretuar dhe bërë koment sipas tematikës që kanë këngët), edukatën qytetare (kur kënga mund të trajtojë çështje të tilla si sjellja, familja, shoqëria etj), edukimin fizik (kombinimi i lëvizjeve trupore me muzikën që ata këndojnë), biologjinë ku trajtohet frymëmarrja si proces jetësor, me fizikën ku trajtohen njohuri si: lëkundja, tingulli, zhurma, akustika, jehona, dëgjimi, vegla muzikore etj.

Integrimi në linjën e DM mund të bëhet me historinë (zhvillimet e muzikës pas luftës së dytë botërore), gjeografinë (Vendlindja dhe kultura e kompozitorëve të ndryshëm të muzikës).

Integrimi në linjën e SHKM mund të bëhet me letërsinë (bërja e një ese -je, edukimin figurativ – përjetimi i muzikës duke e shprehur atë përmes një vizatimi, edukimin fizik – përjetimi i muzikës përmes lëvizjeve ritmike).

Aspektet kros-kurrikulare janë patur parasysh në shtjellimin e rubrikave të programit. Gjatë zbatimit të tij një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet:

- çështjeve të mjedisit, ndotjes dhe mbrojtjes së tij;
- kulturës së komunikimit (aftësimi të nxënësve për të kuptuar dhe zbatuar informacionin e shkruar në jetën e përditshme;
- mjeteve të informimit si media dhe masmedia, internetit;
- përdorimit të teknologjive të informacionit, mjeteve audio-vizive, kompjuterit;
- përdorimit të gjuhës së huaj;
- edukimit për të drejtat e njeriut;
- çështjeve të barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare;
- atdhedashurisë (informacion kulturor - artistik, ekonomik, social, historik, gjeografik);
- globalizmit.

7. Metodologjia e zbatimit të programit

Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga përdoruesit e këtij programi, për të ndihmuar sa më mirë zhvillimin e procesit mësimor. Të tilla mund të jenë: konkurse muzikore, lojëra didaktike që lidhen me zhvillimin ritmik dhe melodik, me dëgjimin, verifikimin e njohurive me teste etj.

Një vend shumë të rëndësishëm në organizimin e orës së mësimi ka formulimi i objektivave, si dhe zbatimi i drejtë i parimeve metodologjike të mëposhtme:

1. Edukimi i shprehive të të kënduarit. Zhvillimi i shprehive të të kënduarit do të jetë gjithmonë në qendër të punës së mësuesit. Këngët dhe kanonet, të kënduara individualisht apo në grup, kërkojnë një përqendrim më të madh, për arsye se në to konkurrojnë së bashku tri elemente, të cilat kanë forcë shprehëse të papërshkrueshme: *vija melodike, teksti, interpretimi.*

Zbatimi i këtyre elementeve bën që kënga të këndohet nga nxënësit jo në mënyrë formale, por në mënyrë shprehëse. Nxënësit duhet të njihen mirë me figurën poetike e muzikore të këngës që mësojnë e këndojnë. Çdo përdorues duhet t'u mësojë e të ushtrojë në mënyrë sa më të drejtë të nxënësit, të kënduarit shprehës, ku gjatë të kënduarit, ata duhet të shprehin përmbajtjen dhe karakterin e këngës. Një interpretim i bukur, bëhet i mundshëm vetëm në bazë të shprehive vokale të përmendura më lart.

2. Zhvillimi i njohurive muzikore vazhdohet edhe në këtë nivel pa sforco dhe duke i transmetuar ato në një mënyrë të thjeshtë. Mësimi i këtyre njohurive nuk përbën një qëllim në vetvete, por ato janë mjeti që do t'i ndihmojë nxënësit për të kuptuar muzikën dhe për ta përvetësuar atë sa më lehtë.

Kuptimi i shkallëve me # dhe b, ndërtimi dhe këndimi i tyre mbi këto shenja, kërkon vëmendje dhe kujdes.

Ritmet e përziera 5/8 e 7/8 dhe 9/8 me pushimet përkatëse zhvillohen në këtë nivel të përshkallëzuar. Edhe shembujt e sjellë në këto ritme bëjnë që nxënësit të njohin më mirë muzikën dhe karakteristikat e vendit të tyre.

Muzika popullore dhe vlerat e saj duhet të nxirren në pah nga mësuesi duke sjellë dhe shembullin si: futja e muzikës polifonike në Unesko.

Ushtrimet didaktike që do të shoqërojnë programin përmes tekstit të nxënësit, të jenë të thjeshta, melodioze, në shërbim të temës që mësojnë.

Informacioni që ata do të marrin për muzikën në periudha të ndryshme dhe përfaqësuesit e tyre, do të plotësojnë formimin e tyre rreth muzikës.

Edukimi me instrumentin dhe loja me të. Në edukimin muzikor të nxënësve një rol të rëndësishëm luan edhe instrumenti muzikor, fyelli (ose tastiera). Luajtja me këtë instrument rrit ndjeshmërinë e nxënësve, shton interesin për muzikën, u zhvillon ndjenjën ritmike, melodike e harmonike, u krijon ide të qarta për anën teorike e praktike të muzikës. Krahas tyre, mësuesi të ketë parasysh që nxënësit të shoqërojnë melodi këngësh, ushtrime melodike etj.

Edukimi për zhvillimin e shprehive gjatë dëgjimit muzikor. Për të formuar një kulturë të drejtë muzikore nxënësve, vëmendja e mësuesit përqendrohet te vlerat artistike të pjesëve të zgjedhura për dëgjim, të cilat të përkohet me periudhën në cilën është shkruar apo gjininë për të cilën dëgjohet dhe flitet. Gjithashtu, këto pjesë muzikore duhet të plotësojnë kërkesat pedagogjike. Dëgjimi, si dhe kuptimi i një pjese muzikore, kërkon një përqendrim më të madh se ndaj një kënge. Prandaj është detyrë e përdoruesve të programit që këto vështirësi t'ua lehtësojë nxënësve, duke i drejtuar për një dëgjim sa më të drejtë, duke i kthyer ata në dëgjues të aftë për të ndjekur muzikën e çdo gjinie qoftë ajo, duke i aftësuar ata për të mbajtur qëndrim ndaj muzikës dhe duke u shprehur me fjalë të thjeshta. Për zhvillimin e kësaj ore, një rol të rëndësishëm kanë edhe mjetet mësimore që mundësojnë zbatimin me sukses të dëgjimit muzikor. Dëgjimet muzikore, të shoqëruara me shpjegime dhe biseda, kanë rëndësi të madhe, sepse përforcojnë njohuritë e muzikës. Nga ana tjetër, zhvillohen te fëmijët elemente të emocioneve estetike, një nga shfaqjet e para të cilave është kënaqësia që provojnë kur dëgjojnë muzikë.

Udhëzime të vecanta

Mjetet mësimore

Që ky programi të bëhet sa më i zbatueshëm dhe konkret si për nxënësit, ashtu edhe për mësuesit, duhet të shoqërohet me bazë materiale, mjete mësimore dhe burime të ndryshme. Libri i mësuesit dhe kasetat me materialet didaktike, si: këngë, pjesë të ndryshme për dëgjim, të shoqërojnë zbatimin e këtij programi.

Mjeti me përdorim vetjak është fyelli, të cilin ta ketë çdo nxënës së bashku me librin. Gjithashtu, mjetet me përdorim kolektiv mund të jenë: magnetofoni, kasetat, tastiera, postera të ndryshëm etj.

Veprimtaritë muzikore jashtë klasës

Si dhe është përcaktuar në programin e klasave parardhëse, mësuesi i edukimit muzikor do ta përqendrojë vëmendjen krahas mësimin, edhe në veprimtarinë artistike jashtë tij. Për këtë, të mbahen parasysh udhëzimet për çdo fillim viti shkollor që dërgon MASH, si dhe tradita e veprimtarisë artistike që ka krijuar shkolla.

8. Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësve në këtë lëndë të bëhet përmes përfundimeve që arrin nxënësi/sja gjatë veprimtarisë praktike, d.m.th. përmes të kënduarit, të luajturit, të analizuarit të pjesëve muzikore etj. Vlerësimi bëhet në atë çka nxënësi ka përvetësuar dhe është i aftë të bëjë. Verifikimi i njohurive të nxënësve mund të bëhet edhe me anë të *testimit*, e cila, është një nga teknikat e vlerësimit. Testi ka rëndësi për të parë qëndrueshmërinë e dijeve të marra, si dhe nxjerrjen në pah të aftësive në të gjitha linjat. Një ndihmë në zhvillimin e testeve japin dëgjimi i kasetave, fjalëkryqet etj.